



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data 14.07.2020	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
01-104/	02-1342	1/.

Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2020

Raporti i punës së KKSBB –së për vitin 2019

Takimi i parë i KKSBB për vitin 2019 është mbajtur me **19 shkurt 2019**, të cilën e udhëhoqi Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, ndërsa për gjendjen e sigurisë në komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë, i cili gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve e vlerësoi të qetë si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2018, ku krahasuar me vitin paraprak (2017) u tha se ka pasur ulje të veprave kriminale.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime:

- 1.Të punohet bashkërisht në luftimin e dukurive negative,
- 2.Të hulumtohen hapësira për parkingje,
- 3.Të bëhet selektimi i punëve të kryera të nxjerra nga rekomandimet e vitit të kaluar,
- 4.Të intervenohet në hendeqet e krijuara nëpër disa rrugë,
5. Kompania KEDC të tregoj seriozitet në punën e tyre,
- 6.Të mos pengohen iniciativat e mira të qytetarëve nga zyrtarët komunal,
- 7.Kompania „Pastërtia” të kryejë shërbimin e duhur ndaj qytetarëve.

Monitorues në këtë takim ishin përfaqësues nga OSBE .

Takimi i dytë i KKSBB është mbajtur më **17.04.2019** që është kryesuar nga Nënkryetari i Komunës, në këtë takim janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e qytetarëve.

Për herë të parë në këtë takim prezantoi Komandanti i ri i Stacionit Policorë z.Halim Shehu i cili kërkoi bashkëpunim të mëtutjeshëm me të gjithë akterët e sigurisë në komunën tonë si dhe raportoi mbi gjendjen e sigurisë si dhe mbi planin operativ të këtij stacioni.

Rekomandimet e nxjerra nga ky takim ishin:

- 1.Kërkohet bashkëpunim edhe më i mirë i institucioneve të sigurisë,
 - 2.Të shfrytëzohen oborret e shkollave nëse paraqitet nevoja për parkingje në sezonin e verës,
 - 3.Të merren masa në parandalimin e përhapjes së dukurisë së vjedhjes,
 - 4.Të parashihet buxhet edhe më i madh për rastet emergjente,
 5. Të krijohet një grup i përbashkët nga anëtarët e KKSBB-së dhe Komunës për evidentimin e rasteve më urgjente për të intervenuar në teren,
 - 6.Të vendosen barrierat dhe shenjat e komunikacionit aty ku është e arsyeshme për tu vendosur.
- Këtë takim e monitoruan përfaqësues nga MAPL dhe nga Inspektorati i Policisë së Kosovës .

Më datë 19. 06 2019 është mbajtur takimi i tretë me radhë KKSBB-së të cilin e kryesoi Nënkryetari i Komunës z.Ylber Bajra, në këtë takim ishte prezent edhe Kryetari i komunës z.Besim Ilazi.

Në këtë takim kryesisht u diskutua në lidhje me përgatitjet që janë bërë për sezonin verorë si dhe u diskutua rreth gjendjes së sigurisë në komunën tonë. Në bazë të asaj që u dëgjua nga Komandanti i Policisë, në periudhën në mes dy takimeve ka rezultate të mira në zbulimin e veprave kriminale dhe u apelua që gatishmëria e institucioneve të sigurisë për përballimin e sfidave të jetë edhe më i madh.

Në fund të këtij takimi janë nxjerrë edhe rekomandime të cilat ishin :

- 1.Të merren masa paraprake për sezonin e verës (parandalimin e zjarreve, ndotja akustike, parkingjet ilegale, ndotja e ambientit, prerja ilegale e pyjeve etj),
- 2.Të bëhet meremetimi i rrugëve të dëmtuara,
- 3.Përkushtim edhe më i madh në zbulimin e rasteve të vjedhjeve,

Monitorues në këtë takim ishte përfaqësuesi i OSBE-së.

Më **22.08.2019** është mbajtur takimi i IV radhë që e udhëhoqi Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi ndërsa për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë i cili tregoi se plani operativ „Preventiva” që është në implementim e sipër , ka dhënë rezultatet e para dhe është treguar shumë efikas në parandalimin e krimit si dhe në identifikimin dhe kapjen e personave të dyshuar. Komandanti gjithashtu tha se rezultate të mira janë arritur edhe në mbrojtjen e pyjeve, ku janë identifikuar dhe janë kapur në flagrancë një numër i madh i dëmtuesve. Plan operativ – Realizimi i Urdhëresave Gjyqësore 2019 është në realizim e sipër dhe rezultatet janë evidente përkundër sfidave që paraqiten në teren.

Në këtë takim me kërkesë të anëtarëve të KKSBB prezantuan edhe Ferat Malsiu përgjegjës i Kompanisë „Pastërtia” dhe Sami Stagova përfaqësues nga OMM „Gjethi” me të cilët diskutuam për çështjen e mbrojtjes së ambientit si dhe trajtimi i mbeturinave .

Nga ky takim dolën këto rekomandime:

- 1.Inspektorët e tregut dhe ata të ambientit të jenë më aktiv në kryerjen e detyrave të tyre
- 2.Të zgjidhet çështja e transportit publik në fshatin Biçec,
- 3.Angazhim dhe bashkëpunim më i madh i institucioneve relevante dhe familjeve në rastet e trajtimit të personave me sëmundje mentale,
- 4.Të organizohen aktivitete vetëdijësuese për riciklim dhe trajtim të mbeturinave,
- 5.Të shtrihen shërbimet e mbledhjes së mbeturinave në tërë territorin e komunës,
- 6.Të shtohen kapacitetet e ujit të pijshëm,
- 7.Në Planin Zhvillimor Komunal të parashihet edhe trajtimi i ujërave të zeza,
- 8.Të bëhet presion edhe më i madh ndaj Komunës së Ferizajit për të parandaluar ndotjen e lumit Nerodime,
- 9.Së paku një herë në vit të bëhet pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve në territorin e Komunës tonë,
- 10 Të merret vendim nga Kuvendi Komunal për ndalimin e ndërtimit të hidrocentraleve në lumenjtë dhe përrenjtë në territorin e Komunës tonë,
11. Të kërkohet që menaxhimi i kompanisë së mbeturinave t'i kaloj nivelit lokal.

Mbledhja e V e KKSBB u mbajt më datë **25.10.2019** të cilën e kryesoi Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi, ndërsa për situatën e sigurisë raportoi togër Skender Neziri , i cili na informoi se gjendja e sigurisë në komunën e Kaçanikut në periudhën në mes dy takime ka qenë e qetë dhe stabile dhe ka përmirësime të dukshme në çdo aspekt, falë bashkëpunimit të mirë që kemi pasur me inspektorët komunal dhe qytetarëve.

Në këtë takim prezantoi edhe Fatlume Guri , anëtare e komisionit për hapjen e kutive të ankesave të qytetarëve e cila na informoi se është hapur kutia e ankesave në objektin e Komunës ku kemi hasur 5 ankesa të cilat janë dërguar në drejtoritë në të cilat u janë parashtruar.

Monitorues në këtë mbledhje ishte Eldin Buzovic nga ICITAP (ICITAP-Program amerikan këshillëdhënës në MPB).

Rekomandimet nga ky takim ishin:

- Komisioni për hartimin e planit të punës së KKS-së për vitin 2020 të hartojë këtë plan dhe t'a bëjë gati për miratim në Kuvend Komunal,

- Të detyrohet me ligj kujdestaria e barnatoreve,

- U kërkua një bashkëpunim edhe më i madh në mes institucioneve për siguri dhe komunitetit,

- Të merren masa ndaj kompanive që gjatë kryerjes së punës së tyre bllokojnë rrugët me material të panevojshëm.

Mbledhja e VI-të dhe e fundit për këtë vit u mbajt më datë **24.12.2019** e kryesuar nga Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi. Informacionin mbi gjendjen e sigurisë në Komunën tonë e dha zv.Komandanti i Stacionit të Policisë z.Jaser Jaha i cili vlerësoi se në përgjithësi situata e sigurisë është e qetë por që shqetësuese është dukuria e vjedhjes e cila kohëve të fundit ka marrë hov në disa lokalitete të Komunës tonë . Rreth kësaj çështje ai tha se kanë marrë të gjitha masat që akterët të gjinden dhe kërkoj edhe ndihmën e qytetarëve për dhënien e çdo informacioni që kanë të bëjnë me këtë dukuri.

Edhe anëtarët tjerë shfaqën shqetësimet e tyre në lidhje me këtë dukuri dhe apeluan tek të gjithë akterët e sigurisë që kjo dukuri të merr fund ngase është bërë një shqetësim i madh për gjithë qytetarët.

Në këtë takim gjithashtu u diskutua në lidhje me masat që ka ndërmarrë Komuna për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin e dimrit si dhe planet për të evituar çdo sfidë që mund të paraqitet gjatë kësaj sezone.

Në fund të këtij takimi u nxjerrën edhe disa rekomandime të cilat ishin:

1. U kërkua një bashkëpunim edhe më i madh i institucioneve të sigurisë dhe komunitetit në luftimin e dukurisë së vjedhjeve dhe çdo dukurie tjetër që cenon sigurinë e qytetarëve,

- 2.Të monitorohet puna e Kompanisë së përzgjedhur në mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit të dimrit,

3.Të organizohet edhe punë vullnetare nëpër lokalitete nëse paraqitet nevoja gjatë sezonit dimëror,

4.Sa më shpejtë të hyjnë në funksion kamerat e sigurisë të cilat për shkak të punimeve në qytet një pjesë e tyre kanë qenë jashtë funksionit,

5.Të publikohen rastet e efektshme risë së kamerave të sigurisë.

Këtë vit pos takimeve të rregullta që ka mbajtur KKSBB, më datë 28.10.2019 nën organizimin e Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), është organizuar një punëtori në kuadër të projektit „Me Demokraci Pjesëmarrëse për një Kosovë pa Radikalizëm” për anëtarët e KKSBB nga Komuna jonë, e cila punëtori kishte si qëllim ngritjen e kapaciteteve tematike të KKSBB-së, në lidhje me parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm me synim që një kornizë e tillë teorike të shërbejë në formësimin e komunikimit dhe adresimit të çështjeve të kësaj natyre në aktivitetet e politikë-bërjes së sigurisë në komunitet dhe planeve lokale të veprimit.

Të gjitha takimet e mbajtura të KKSBB gjithashtu janë publikuar në web faqen e Komunës.

Kaçanik ,më 13.01.2020

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

